



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 124, viti 2015, “Për eficiencën e energjisë” (*Komision përgjegjës*)

Shqyrtimi dhe votimi nen per nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 "Për peshkimin", i ndryshuar". (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Dorina Çinari - Zëvendësministre e Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës

Entela Cipa – Drejtoreshë e Agjencisë së Eficencës së Energjisë

Enea Karakaci - Drejtor Juridik në MEI

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Në rendin e ditës së sotme kemi diskutimin dhe votimin nen për nen të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124, viti 2015, “Për eficiencën e energjisë”.

Herën e kaluar kemi bërë miratimin në parim dhe diskutimet. Shërbimi i Komisioneve ka përgatitur edhe një draft të propozimeve nen për nen. Para se të kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen, po ia jap fjalën relatorit, zotit Arben Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni shkurtimisht të përmend edhe një herë qëllimin për të cilin jemi sot këtu. Kemi disa ndryshime të propozuara nga Këshilli i Ministrave për ligjin “Për eficiencën energjetike”, të aprovuar në vitin 2015, i cili ka filluar të funksionojë dhe të japë efektet e veta, është ngritur agjencia, është hartuar plani kombëtar për eficiencën energjetike. Sot jemi për disa ndryshime, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me procesin e deregulimit. Kemi disa ndryshime në nenet përkatëse, të cilat bëjnë kalimin nga licencimi në certifikim për ta thjeshtuar sa më shumë këtë procedurë. Pas aprovimeve që do të bëjmë sot, ligji do të fillojë të ketë edhe efekte të tjera, që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe përgatitjen e manualeve përkatëse dhe ngritjen e fondit, që të mund të hyjë në fuqi dhe të ketë efekte të drejtpërdrejta për qëllimin që është aprovuar.

Jemi sot gati 4 vjet pas aprovimit të këtij ligji. Jemi pak me vonesë, ndaj i bëjmë një apel ministrisë dhe agjencisë që të ecin më shpejt në këtë drejtim. Gjithsesi, kemi disa ndryshime nen për nen, një pjesë të të cilave i kemi rakorduar edhe me propozuesit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Pa humbur kohë, fillojmë shqyrtimin nen për nen.

Propozohet që pika 2 e nenit 1 të riformulohet: “auditues energjetik është një person fizik ose person juridik, që ka të punësuar auditues energjie të certifikuar, i cili kryen auditime energjetike në përputhje me përcaktimet e këtij ligji”.

Nëse është e nevojshme, mund ta lexoj si është. “Auditues energjetik është një person fizik që kryen auditime ...

Apo kjo është ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Tabelën e keni parë.

Nëse jeni dakord, votojmë nenin 1, sipas variantit të komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arben Pëllumbi – Zoti kryetar, ndryshimi në këtë pikë ka të bëjë me faktin që në variantin e propozuar nuk specifikohet që personi juridik duhet të ketë të punësuar një auditues të certifikuar. Pra, në vetvete, nuk përcaktohet qartë se kur e merrte të drejtën e audituesit personi juridik. Personi juridik e ka këtë të drejtë kur ka një person të certifikuar si të tillë, të punësuar. Këtë specifikojmë në këtë pjesë, ky është ndryshimi.

Niko Peleshi – Dakord.

Jeni dakord të miratohet neni 1 me këtë ndryshim? Kundër? Nuk ka.

Miratohet, sipas variantit të përgatitur nga komisioni.

Neni 2.

Arben Pëllumbi – Nuk ka.

Niko Peleshi – Neni 2 nuk ka ndryshime.

Kush është dakord të miratohet, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër?
Nuk ka.

Miratohet sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

Neni 3 ka një propozim për ndryshim.

Pika 1 riformulohet si më poshtë, e keni tabelën.

“Audituesi energjetik për kryerjen e veprimtarisë së auditimit energjetik pajiset me certifikatë nga ...” Duhet të përcaktojmë cili e lëshon certifikatën. Do të jetë agjencia apo ministria?

“Agjencia për eficiencën e energjisë mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të audituesve energjetikë”.

Relatori të bëjë një prezantim, cili është thelbi i ndryshimit, që unë të mos bëj lexim, pasi tabelën e kemi.

Arben Pëllumbi – Atëherë, ka dy variante. Një variant është që këtë të drejtë ta ketë agjencia ose varianti tjetër është ta ketë ministria.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te neni 3.

Ne kemi rakorduar që të drejtën për të dhënë certifikatë ta ketë agjencia, ndërkohë që më poshtë do të shikojmë se për të forcuar mbrojtjen e atij që merr certifikatë, heqjen e certifikatës ta ketë ministri. Edhe në kuadër të deregulimit...

Niko Peleshi – Të dëgjojmë zëvendësministren dhe më pas bëjmë diskutime.

Dorina Çinari – Meqenëse po flasim për deregulim, mendojmë që certifikatat t'u kalojnë agjencive. Ky është edhe parimi i reformës që kemi nisur. Pra, certifikatën e lëshon Agjencia për Eficiencën e Energjisë. Ky është propozimi ynë. Se cili e heq certifikatën... Ndoshta ka ndonjë opinion më të mirë, por ne thamë të ketë një autoritet më të lartë për ta mbrojtur të certifikuarin. Nëse ka ndonjë opinion tjetër, jemi të hapur ta dëgjojmë.

Niko Peleshi – Ky është i vetmi ndryshim në këtë nen apo jo?

Dorina Çinari – Po.

Niko Peleshi – Ka komente?

Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – Duhet të ndajmë dy momente. Kur ka shkelje, mund ta heqë edhe institucioni që e ka dhënë. Nëse ndodhin shkelje shumë shumë të rënda, mund të ndërhyjë ministri. Të merret ministri gjithmonë me ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vë firmën, po e njëjta gjë është, sepse firmë është përgjegjësi.

Unë mendoj kështu.

Niko Peleshi – Po, zoti Marto.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se është logjike që licencës duhet ta heqë ai që e jep. Domethënë, është më normale.

Robert Bitri – Në këtë linjë jam edhe unë, normalisht. licencimin e heq ai që e jep. Nëse ia lëmë agjencisë licencimin, po ajo ta bëjë edhe heqjen. Po ia lamë ministrisë licencimin, ta ketë ministria të drejtën e heqjes së licencës. Ky është mendimi im.

Niko Peleshi – Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se duhet të jetë e njëjta logjike, siç është me audituesit financiarë. Nëse e jep ministria apo ministri, të njëjtën gjë do të bëjë. Logjikisht nuk shkon ta japë një institucion dhe ta heqë ministri. Më duket shumë e palogjikshme. Nuk e di çfarë përvojë ka, ku e keni marrë si model ose nëse e kemi si model apo përvojë, por logjikisht, në ministri, kur jepen licenca të caktuara, ka komisione që monitorojnë. Sigurisht, në momentin që jepen, bëhet nga komisionet, por nga ministria. Mendoj se kjo është mënyra më e mirë që funksionon deri tani, të paktën. Nëse vërtet me derregullimin i marrin agjencitë këto kompetenca, sigurisht që duhet të marrin edhe përgjegjësi për t'ia hequr. Mendoj se kështu shkon si logjikë.

Dorina Çinari – Logjika e deregulimit është që ne të thjeshtësojmë eksetet për qytetarët, për të interesuarit, dhe t'i kalojmë pranë institucioneve të varësisë, të mos e ketë ministria barrën e dhënies së certifikatave dhe licencave.

Ne jemi dakord, nëse mendoni se agjencia duhet ta japë dhe ta heqë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kryesisht është përgjegjëse për politikën. Ata nuk merren me certifikime. Procesi i ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po.

Arben Pëllumbi – Gjithsesi, në pikën 1 kemi dhënien e licencës. Revokimi është pika 8 e po këtij neni.

Niko Peleshi – Dakord.

Arben Pëllumbi – Kur të shkojmë te pika 8...

Niko Peleshi – Te pika 8 e po këtij neni?

Arben Pëllumbi – Po. Në pikën 1, edhe ministria, edhe unë si relator, jemi dakord ta lëmë siç është, që ta japë agjencia.

Niko Peleshi – Te ky nen jemi, ndaj ta shterojmë diskutimin.

Arben Pëllumbi – Te pika 8 mund ta diskutojmë sërish se cili do ta heqë, sepse kemi ndryshime të tjera edhe në pikën 2, edhe në pikën 3.

Niko Peleshi – Dakord.

Ka konsensus që pika 1 e nenit 3 të saktësohet apo të ndryshohet, duke thënë se pajiset me certifikatë nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë.

Nëse ka konsensus për këtë pikë, e saktësojmë në pikën 1, siç e thashë më sipër.

Ndërkohë, pika 2...

Arben Pëllumbi – Një minutë, ju lutem, sepse kemi edhe shtesën që përveçse jep, edhe mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të audituesve energjetikë.

Niko Peleshi – Këtë e kemi parë dhe nuk ka diskutim.

Arben Pëllumbi – Jo, është shtesë në këtë pikë, sepse nuk ishte kështu në variantin e parë.

Niko Peleshi – Më falni, po diskutojmë për nenin 3, sipas propozimit në tabelën që keni.

Arben Pëllumbi – Po.

Niko Peleshi – Nëse duhet ta lexojmë të gjithë propozimin, e lexoj, ose e lexoni ju, relator.

Pra, do të ecim kështu. Ju prezantoni propozimin e nenit. Bëjmë diskutime, nëse ka, dhe ndryshimet e nevojshme për propozimet. Më pas lexojmë variantin përfundimtar dhe e votojmë.

Arben Pëllumbi – Varianti i propozuar në fazën e tij fillestare në pikën 1 është: “Auditues energjetik është një person fizik i certifikuar ose person juridik që ka të punësuar auditues energjetik të certifikuar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Kalojmë te neni 3.

Lexoni propozimet.

Arben Pëllumbi – “Audituesi energjetik, për kryerjen e veprimtarisë së auditimit energjetik, pajiset me certifikatë”, e cila nuk ishte e specifikuar se nga cili dhe themi “nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë dhe mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të audituesve energjetikë”. Ky është varianti përfundimtar i propozuar dhe i rakorduar edhe me ministrinë.

Niko Peleshi – Nuk ka diskutime të tjera, sepse thamë që kemi konsensus për këtë formulim, por thamë që do ta votojmë në fund.

Vazhdojmë më poshtë.

Arben Pëllumbi – Në pikën 2 shtohet vetëm fjala “për dhënien e certifikatës”.

Dorina Çinari – Unë jam për ministrinë.

Arben Pëllumbi – E kërkon procesi i deregulimit.

Niko Peleshi – Dakord.

Kemi dy propozime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, kemi hedhur në votim vetëm nenin 1.

Do ta hedhim, por do ta prezantoj të gjithë nenin.

Arben Pëllumbi – Në pikën 2 shtohet fjala “procedurë”. Pra, “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për Energjinë, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar, sipas pikës 1 të këtij neni. Shtohet edhe fjala “procedurë”, që nuk ishte parashikuar në tekstin origjinal.

Niko Peleshi – Pika 4 hiqet.

Arben Pëllumbi – Personalisht do të doja që ne ta diskutonim, sepse më duket pak e tepërt. Audituesi energjetik detyrohet të regjistrojë në regjistrin tregtar, ndërkohë që ai nuk merr dot certifikatë nëse nuk e ka të regjistruar në objektin e vet këtë gjë.

Heqim pikën 4.

Si pika 3, si pika 4, mua m'u dukën të tepërta në këtë pjesë, por, dëgjojmë edhe variantin e ministrisë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Person – Përderisa ne pranojmë të ketë një kontratë dhe ta quajmë të gjithë firmën sikur e ka këtë të drejtë certifikimi, logjika është që automatikisht ai nuk ka pse të regjistrohet, sepse është i regjistruar dikush tjetër. Përderisa e kemi të regjistruar në faqen zyrtare dhe atje unë, për shembull, bëj një kontratë pune me një auditues të certifikuar dhe automatikisht marr të drejtën të bëj edhe veprimin.

Niko Peleshi – Më falni, që të mos e bëjmë lëmsh.

Zoti Pëllumbi, ju keni një propozim tjetër, përveç propozimit që kam unë përpara?

Arben Pëllumbi – Pika 3... Ministria bashkë me juristët e komisionit kanë rënë dakord të heqin pikën 4. Unë propozoj të mos jetë edhe pika 3.

Niko Peleshi – Të hiqet edhe pika 3, thoni ju.

Arben Pëllumbi – Po,

Niko Peleshi – Mund të vazhdoni deri në fund me prezantimin e nenit dhe në fund do të hapen diskutimet.

Arben Pëllumbi – Ndryshimi tjetër që propozohet kalon në pikën 8, ku flitet për revokimin e certifikatës, ajo që nisëm të diskutojmë pak më parë...

(Diskutime pa mikrofon)

Nenet 6 dhe 7 do të ngelen ashtu siç janë në variantin fillestar, sepse nuk ka ndryshime për to.

Niko Peleshi – Për pikën 8 ju thoni: “Vendos revokimin e certifikatës të audituesit energjetik të në rast se...”

E keni fjalën për ministrinë?

Arben Pëllumbi – Ndryshe nga teksti origjinal, të cilin do të diskutojmë nëse do të jetë apo jo ministria, ajo që nisëm këtu është edhe një shtim, ka të bëjë me revokimin e certifikatës të audituesit, kjo që shtohet është vetëm për saktësim terminologjie. Ende nuk kemi diskutuar dhe rënë dakord për konceptin, nëse do të jetë ministria apo jo.

Niko Peleshi – Pika 9 qëndron ashtu siç është në draftligjin e Këshillit të Ministrave. Po për pikën 10?

Arben Pëllumbi – Sa i takon pikës 10, kemi një ndryshim. Pra, është thjeshtë çështje riformulimi duke përdorur fjalën “revokim të certifikatës”. Pra, meqenëse edhe në

nenin 8 flitet për revokim, po ashtu edhe në nenin 10 duhet të flitet për revokim e jo për ndalim, është thjesht çështje terminologjie dhe nuk ka ndonjë ndryshim tjetër.

Niko Peleshi – Dakord.

A ka diskutime?

Po, zoti Suli.

Rakip Suli – Kisha diçka për nenin 3. Në nenin 3 thuhet: “Audituesi energjetik është një person fizik ose person juridik i certifikuar, që ka të punësuar auditues energjetik të certifikuar”. Unë jam person fizik i certifikuar dhe shkoj të marr licencë, atëherë pse duhet të kem të punësuar? Pra, te kjo pjesë duhet të jemi të kujdesshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Duhet lexuar me kujdes, në vijimësi. Pra, ai certifikohet, regjistrohet te QKB-ja dhe është një person fizik që ka të drejtën e kryerjes së...

Dorina Çinari – Aty thuhet që është një person fizik ose juridik që ka punësuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Kur është fizik ajo gjë është...

Rakip Suli – Ndoshta e keni ndryshuar më pas, por sa i takon nenit 3 në të thuhet: “Audituesi energjetik është një person fizik i certifikuar ose person juridik që ka të punësuar...”

Niko Peleshi – Është e interpretueshme...

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Suli, ka të drejtë. Unë mendoj se duhet bërë një riformulim më i mirë, sepse në mënyrën që është duket sikur fjala është edhe për personin fizik dhe atë juridik. Pra, duhet specifikuar që bëhet fjalë vetëm për personin juridik...

Manjola, si mund të riformulohet?

(Diskutime pa mikrofon)

A ka ndonjë propozim për riformulim?

Dorina Çinari – Person fizik i certifikuar ose person juridik që ka të punësuar një person të certifikuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Jo, nuk është kështu...

Enis Karapici – Personi juridik që ka të punësuar audituesin e certifikuar ose person fizik i certifikuar...

Entela Cipa – Po, pika 2 riformulohet, thjesht do të shtojmë...

(Diskutime pa mikrofon)

Problemi fillon që sipër...

(Diskutime pa mikrofon)

Rakip Suli – Neni 1 duhet ndryshuar, sepse kjo gjë nuk është e qartë...

Niko Peleshi – Nenin 1 e votuam, megjithatë për saktësim po e lexoj edhe një herë. Në nenin 1, pika 2 riformulohet: “Auditues energjetik është një person fizik i certifikuar ose personi juridik që ka të punësuar auditues energjie të certifikuar, i cili kryen auditime energjetike në përputhje me përcaktimet e këtij ligji”.

A jeni të gjithë dakord me këtë formulim?

A ka ndonjë kundër? Jo.

Atëherë miratohet siç jua lexova.

Vazhdojmë me diskutimin për nenin 3. Nga diskutimet e deritanishme në lidhje me këtë nen ka disa opsione.

Së pari, zonja Gjermani propozoi që certifikata të lëshohet dhe të revokohet nga ministria...

(Diskutime pa mikrofon)

... ndërkohë relatori propozon që lëshimin ta bëjë agjencia, revokimin ta bëjë ministria. Këtu në komision patëm edhe diskutime të tjera, sepse disa prej jush mendonin që këto duhet të jenë të lidhura. Pra, kush e lëshon duhet edhe ta revokojë. Unë personalisht jam me këtë qëndrim. Meqenëse edhe nga vetë ministria ka mirëkuptim, personalisht do të isha dakord që kjo t’i ngelet agjencisë, ta ketë ajo edhe lëshimin, dhe revokimin e certifikatës.

Fjala për ju.

A ka mendime të tjera?

Do të votojmë 2 propozimet që u bënë?

Ndërkohë, ka një propozim nga zoti Pëllumbi, pika 3 të hiqet, sepse nga propozimi që ka bërë komisioni kjo pikë nuk është hequr.

Arben Pëllumbi – A mund ta sqaroj pikën 3, pavarësisht se nuk është thelbësore. Pika 3 i referohet vetëm faktit që në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si objekt të veprimtarisë tregtare të shoqërisë tregtare, në qoftë se është person juridik, duhet të jenë edhe çështjet e audituesit energjetik. Pra, shoqëria tregtare, ju e dini, mund të ketë me qindra çështje në objektin e veprimtarisë së saj, ama, sipas pikës 3 të këtij neni, referohet thjesht fakti që një shoqëri, e cila kërkon të ushtrojë funksione, aktivitete auditimi energjie duhet ta ketë të specifikuar edhe në regjistrin e tregtar të saj se objekt të ushtrimit të aktivitetit ka edhe...

(Deputeti Bitri ndërhyr pa mikrofon.)

Në rregull.

Robert Bitri – ...futen njerëzit nëpër tenderë, patjetër tani duhet ta kenë të regjistruar këtë dhe të eliminohet? Jo, unë nuk jam dakord. Në qoftë se e ka një kontratë pune, pse të mos bëhet?

Arben Pëllumbi – Atëherë, ideja nëpërmjet së cilës unë propozoj heqjen e kësaj është sepse në një pikë më lart themi: “Këshilli i Ministrave miraton procedurën” dhe në procedurë është krejtësisht normale që ai, i cili paraqitet, ta ketë të shkruar tek objekti këtë gjë.

Dakord që të mos jetë si pikë më vete, por që të mos ekzistojë si koncept... Si koncept duhet të jetë patjetër.

Niko Peleshi – Çfarë pune prish po të jetë si pikë më vete?

E kanë të gjitha.

Besoj se kjo është rutinë legjislative, apo jo, Manjola?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Në rregull.

Niko Peleshi – Në qoftë se nuk ka ndonjë kundërshtim apo në qoftë se ka mirëkuptim edhe nga zoti Bitri, pika 3 le të mbetet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, kemi propozimin e formuluar nga komisioni me dy opsione: njëri opsion është agjencia, tjetri është ministria.

Meqenëse ky nen ka disa pika, po i votojmë pikë pas pike.

Atëherë, hedhim në votim propozimin për pikën 1 të nenit 3, pra për t’i qëndruar agjencisë: “Auditues energjetik për kryerjen e veprimtarisë së auditimit energjetik pajiset me certifikatë nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë. Agjencia e Eficiencës së Energjisë mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të audituesve energjetikë”, ky është opsioni.

Kush është dakord me këtë propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa jemi? Tetë vota pro.

Kush është kundër? Pjesa tjetër e deputetëve është kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, fiton ky propozim, pra i ngelet agjencisë.

Te pika 2, pas fjalës “miraton”, shtohet fjala “procedurën”. Kush është dakord me këtë formulim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet pika 2, sipas propozimit.

Për pikën 3 thamë se do të qëndrojë.

Pika 4 propozohet të hiqet. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Pika 8. Edhe këtu kemi dy opsione, ku njëri është të jetë i njëjti institucion që e lëshon certifikatën dhe e revokon, pra rrjedhimisht Agjencia, ndërsa opsioni tjetër është që të revokohet nga ministria.

Hedhim në votim opsionin e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fjalinë hyrëse të pikës 8, fjalët “vendos ndërprerjen e ushtrimit të këtij aktiviteti nga audituesi energjetik përkatës në rast se” zëvendësohen me fjalët “vendos revokimin e certifikatës së audituesit energjetik në rast se”, por në krye të kësaj pike duhet të jetë agjencia, pra “Agjencia vendos revokimin e certifikatës së audituesit energjetik”. Ky është propozimi i parë. Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I numëruat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, me tetë vota pro, pra me shumicën e votave miratohet varianti se do të jetë agjencia, e cila vendos revokimin e certifikatës së audituesit energjetik. Komisioni do të bëjë formulimin e saktë, por ky është propozimi që u votua.

Vazhdojmë me pikat e tjera.

Pika 9 nuk ndryshon.

Pika 10 formulohet si më poshtë. Edhe këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, edhe në pikën 9, meqenëse specifikohet: “Ministri njofton me shkrim audituesin energjetik për vendimin e tij”, meqenëse u ndryshua, pra u votua se do të jetë agjencia e cila do ta bëjë revokimin, duhet gjithashtu që fjala “ministri” të zëvendësohet me fjalët “Agjencia për Eficiencën e Energjisë”.

Biem dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 10 ka gjithashtu një riformulim: “Një auditues energjetik, të cilit i është revokuar certifikata, sipas pikës 8 të këtij neni, ka të drejtë të aplikojë për certifikatë të re jo

më vonë se një vit nga data e marrjes së vendimit të mësipërm”. Kush është dakord me riformulimin?

(Deputetja Gjermani kërkon fjalën pa mikrofon.)

Fjalën e ka zonja Gjermani për një vërejtje.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Unë mendoj se duhet të jetë penalizuese, pra të mbetet varianti siç e ka sjellë Këshilli i Ministrave: “jo më herët se një vit”. Nuk mund ta vëmë “jo më vonë se një vit”, sepse ne i kemi revokuar licencën. Si t’i themi: mos u vono, hajde me vrap dhe merr përsëri licencë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka sens.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet t’i lëmë një afat që të penalizohet, se nuk më duket e drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Afatin ju na e sugjeroni, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se i hiqet, duhet t’i lëmë një afat që të penalizohet.

Arben Pëllumbi – Qëllimi ka qenë pikërisht ky. Këtu ka një lapsus në të shkruar. Jemi dakord edhe me ministrinë që duhet “jo më vonë..., por jo më herët se”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – Madje unë mendoj se duhet të jetë “jo më pak se tre vjet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se duhet të jetë jo më pak se tre vjet, pra ai duhet ta marrë një penalizim në tre vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu i bie që ti merr një masë ndaj këtij personi, të cilit ia heq certifikatën, dhe pas një viti e rikthen këtë person.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mendohet që kur i është hequr licenca, ka abuzuar dhe abuzimet janë problematike, sepse ai do të jetë përgjegjësi kryesor për licencimin e një objekti, ku ai objekt nuk do të hipotekohet pa kaluar te kjo tjetra.

Niko Peleshi – Cili është propozimi juaj?

Rakip Suli – Minimumi tre vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Atëherë, saktësimi “më vonë ose më herët” është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – Jo, nuk ka lidhje agjencia, thjesht duhen përcaktuar gjërat.

Niko Peleshi – Është logjikë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por saktësimi është logjik, pra nuk është “jo më vonë”, por është “jo më herët”. Ndërkohë, sa i përket propozimit të zotit Suli kemi dy opsione: i pari është sipas propozimit me 1 vit heqje

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bici, të lutem!

Kemi dy propozime: i pari është sipas propozimit të Këshillit të Ministrave për një vit heqje, kurse propozimi i zotit Suli është për 3 vjet. Ka ndonjë propozim tjetër, apo do t’i votojmë të dy propozimet?

“Deri në 2” është ... Duhet ta përcaktojmë; 1, 2 ose 3.

Dorina Çinari – Zoti Suli, edhe për ne është logjike masa 3-vjeçare. Kush bën shkelje të rënda, për mendimin tim personal, nuk duhet të marrë më fare licencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rakip Suli – Përdërisa është vënë masa për heqjen e licencës, do të thotë që ti nuk mund ta rikthesh për 1 vit. Minimumi duhet të jetë 3 vjet.

Dorina Çinari – Nëse ai ka shkelur germën “a”, ku thuhet se provohet që në procesin e auditimit energjetik janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe kërkesat e përcaktuara, kjo është shkelje e rëndë. Për mendimin tim, nëse ka shkelur ligjin, ...

Besnik Baraj – Atëherë, duhet të ishte pasqyruar në ligj përkufizimi i “shkeljes së rëndë” me pikat përkatëse. Nëse e lëmë evazive, futet faktori njeri dhe korrupsioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi - Nëse duam t’i bashkohemi mendimit të zëvendësministres, mund të shtojmë “në rast të përsëritjes, hiqet dhe nuk merret më”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hedhim në votim propozimin si më poshtë: “Një auditues energjetik, të cilit i është revokuar certifikata sipas pikës 8 të këtij neni, ka të drejtë të aplikojë për certifikatë të re jo më herët se 3 vjet nga data e marrjes së vendimit të mësipërm. Në rast të përsëritjes së shkeljes, certifikata hiqet në mënyrë të pakthyeshme”. Ky ishte formulimi sipas meje,

kurse për teknikën e formulimit përgjigjen shërbimet e komisionit. Kush është dakord me këtë propozim? Kundër nuk ka.

Miratohet me ndryshimin përkatës.

E hedhim në votim në tërësi.

Kush është dakord me miratimin e nenit 3, me ndryshimet sipas pikave që përmendëm dhe votuam? Kundër nuk ka.

Miratohet në tërësi varianti i ndryshuar sipas propozimeve të miratuara pikë pas pike.

Neni 4.

Arben Pëllumbi – Këtu do të kalojmë të njëjtën gjë, por për shërbimet energjetike. Duhet të përcaktojmë se kush është ai që i certifikon. Përsëri flasim për agjencinë. Ndryshimi që bëhet në pikën 2 është që përcaktohet se kush është certifikuesi i shërbimit energjetik.

Niko Peleshi - Për analogji, duhet të jetë agjencia.

Arben Pëllumbi – Jo, jo, shërbimet energjetike. Pra, ai që do të bëjë punën.

Niko Peleshi – Pra, kemi këtë saktësim në pikën 2. Propozohet që të shtohet edhe pika 2\1 me përmbajtje si më poshtë:

Në pikën 3, pas fjalës “miraton”, të shtohet fjala “procedurën”, kurse pika 7 të hiqet. Këto janë propozimet për nenin 4.

I votojmë pikë pas pike.

Kush është dakord me ndryshimin në pikën 2, që shprehja “të ofrohen nga subjekte” të zëvendësohet me fjalët “ofrohen nga persona juridikë që certifikohen nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë”? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord që të shtohet pika 2\1 me përmbajtje si më poshtë: Në pikën 3, pas fjalës “miraton” të shtohet fjala “procedurën”. Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord që të hiqet pika 7? Kundër nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Jo për këtë nen.

E votojmë në tërësi të nenit 4, me ndryshimet që miratuam pikë pas pike.

Kush është dakord? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Zoti Baraj ka një koment.

Besnik Baraj – Ju pohuat që e keni pasur si mendim rastin kur kemi lektorë me tituj akademikë, të cilët japin leksione dhe trajnojnë persona dhe subjekte që do të marrin këtë certifikatë apo licencë.

Në rastin kur njëri prej tyre do që të marrë titullin (ai do të marrë pjesë në leksion, do të ndjekë kurset e të tjera), propozimi im ishte që në këtë rast, të paktën ata që kanë tituj akademikë maksimalë, *ass prof* dhe *prof*, ta kenë si bonus dhe të certifikohen në fushat përkatëse. Unë mendoj që kjo rezonon me shqetësimet e universitetit sot dhe mungesës së lidhjes së problematikës aktuale me universitetin. Pra, ka një fragmentarizëm apo izolim që nuk e gjen në ndonjë vend tjetër.

Entela Cipa – Këto parashikime i kemi marrë parasysh te drafti i vendimit të Këshillit të Ministrave. Janë përjashtuar nga kryerja e kurseve pasuniversitare. Jemi duke diskutuar nëse këta profesorë me tituj dhe grada, por edhe inxhinierët, që aktualisht kryejnë këtë proces pranë universiteteve, do të jenë pjesë e testimit.

Besnik Baraj – Të testojmë profesorët për marrjen e kësaj certifikate?

Entela Cipa – Ky është diskutimi që kemi. Janë përjashtuar nga paraqitja e certifikatës ...

Besnik Baraj – Do të sillni profesorë nga jashtë shtetit?

Entela Cipa – Jemi duke punuar për të pasur bashkëpunim me një nga agjencitë homologe, KFW-në dhe Agjencinë e Eficiencës në Itali për të lidhur një marrëveshje bashkëpunimi për të testuar audituesit e parë, sepse aktualisht ne nuk kemi asnjë auditues të certifikuar. Duhet të kemi një trupë të huaj të certifikuar që të bashkëpunojë me komisionin.

Besnik Baraj – Për mendimin tim ky numër është shumë i kufizuar. Përderisa këta janë trajnerë dhe trajnojnë të tjerë, automatikisht duhet ta kenë mundësinë që të certifikohen automatikisht. Është numër shumë i kufizuar. Ne nuk po e bëjmë për doktorët e shkencave, por për *prof ass* ose *prof*. Ose mund ta kufizosh vetëm në “profesor”.

Arben Pëllumbi – Gjithsesi, nuk është pjesë e diskutimit të këtij ligji, por pjesë e diskutimit të një procedure që vetë agjencia është duke përgatitur në formën e një VKM-je. Ligji nuk mund ta specifikojë ...

Besnik Baraj – Eksperienca ka treguar që kur i lëmë gjërat pa i shqyrtuar në kohën e duhur, ato nuk rimerren dhe rikonsiderohen.

Niko Peleshi – Është e vështirë të shkruhet në këtë ligj. Si mendon, Besnik?

Mbajeni shënim ...

Dorina Çinari – Ne do t'i kemi parasysh rekomandimet dhe në konsultimin përfundimtar që do t'i bëjmë draftit do të përfshijmë edhe këtë kategori të profesorëve. Ndoshta mund të shikohet si diskriminim ndaj të tjerëve, sepse aktualisht ka njerëz që kanë kryer këto kurse jashtë shtetit, fakultetet përkatëse... Të përjashtosh këta dhe t'jua japësh direkt profesorëve shqiptarë...

Këto i kemi pasur në diskutim, por ende nuk e kemi ...

Niko Peleshi – Gjithsesi, mbajeni në konsideratë, sepse do të vini përsëri në këtë komision.

Kush është dakord për miratimin në tërësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 5.

Pse nuk e kisha te tabela?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hedhim në votim nenin 5. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Pro? Kundër nuk ka.

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

Kush është dakord me votimin në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124\2015 “Për eficiencën e energjisë”? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Punë të mbarë dhe suksese!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më datë 05.02.2019, ora 15:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi dhe votimi nen per nen i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012 "Për peshkimin", i ndryshuar". *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Egllantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Edmond Panariti.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Roland Kristo – Zëvendësministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango – Drejtoreshë në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Niko Peleshi – Pikë tjetër në rendin e ditës kemi votimin dhe miratimin në parim, nën për nën dhe në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31. 05. 2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar””.

Ju kujtoj që kemi bërë një seancë me diskutime, pyetje dhe komente me përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërkohë, nuk kemi bërë votimin në parim në seancën e parë pasi është vlerësuar e nevojshme të bëhet një dëgjese me grupet e interesit. Kjo dëgjese u zhvillua dhe me pyetje dhe përgjigje. Besoj se e quajmë të ezauruar pjesën e parë të pyetjeve, përgjigjeve dhe diskutimeve. Kështu që, jemi gati për ta votuar në parim dhe më pas do të vazhdojmë me miratimin dhe diskutimin nën për nën.

Përveç dëgjesës kemi marrë edhe një reagim me shkrim nga zonja Kolaneci, e cila është profesore e asociuar. Ky qëndrim apo mendim, siç u kërkua nga ekspertët e fushës, i zonjës zonja Kolaneci, ju është shpërndarë të gjithë anëtarëve të komisionit dhe ministrisë. Ministria ka dërguar komentet e veta mbi këtë koment, të cilat do t’i diskutojmë nën për nën.

Së fillim e votojmë në parim.

Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.05.2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar””.

Ka kundër në parim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Fillojmë diskutimin nën për nën.

Fjalën e ka relatorja, zonja Gjermani, për të prezantuar ndryshimet nën për nën.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Siç e thatë edhe ju, kanë ardhur disa komente dhe sugjerime, por ka ardhur edhe përgjigja nga ministria, që i hedh poshtë ato.

Megjithatë, janë dy-tri gjëra që do t’i diskutoj dhe do t’i ndaj me ju sipas neneve përkatëse.

Kam disa gjëra parimore, jo thjesht për ligjin, por për pjesën e përkufizimeve. Pyetjet dhe sugjerimet do t’i bëj sipas neneve, që edhe ju të keni mundësi të jepni komente.

Kam diçka në parim për organizatat e peshkimit, për të cilat jam shumë skeptike, nëse do të kenë ose jo kapacitetet e nevojshme për atë që ju u keni atribuuar në këtë ligj, për shkak të organizimit, por edhe të nivelit.

Shqetësimi tjetër që kam lidhet me mënyrën se si do të monitorohen organizatat e peshkimit dhe si do të zbatohet realisht ky ligj.

Fillojmë me nenin 1.

“Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës” zëvendësohet me “institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës”.

Këtu nuk kam ndonjë ndryshim, por në momentin kur përkufizimit “institucioni përgjegjës” i referohemi edhe në nenet e tjera, nuk jam shumë e qartë se çfarë do të thotë. Pashë relacionin e Ministrisë së Financave dhe përgjigjen tuaj, që nuk ka nevojë për ndryshime financiare ose shtesa në buxhet. “Kjo drejtori” dhe ky “institucion përgjegjës” nuk e kuptoj se çfarë do të thotë. “Kjo drejtori është...”, pastaj do t’i referoheni si “institucion përgjegjës”? Vetëm i ndryshon emri? Kapacitetet, aftësitë dhe fushat e veprimit kanë ndonjë ndryshim?

Edlira Llango – Përsëndetje të gjithëve!

Për pyetjen tuaj, zonja relatore, thuhet: “Kudo në ligj emërtimi “Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës” do të zëvendësohet me “institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës”. Pra, zëvendësimi nuk është vetëm në një nen, por në të gjithë ligjin. Kjo është bërë më tepër për çështje të teknikës legjislative, në rast se ky institucion do të ndryshojë në të ardhmen emërtimin, organizmi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, bëhet me VKM. që të mos ketë nevojë për ndërhyrje në ligj. Ky është i vetmi synim pse është bërë kjo ndërhyrje në nenin 1.

Eglantina Gjermani – Dakord.

Ka një sugjerim nga Komisioni i Integritetit, të cilin unë thjesht do ta relatoj. Shënimi në fund të faqes, që lidhet me titullin e projektligjit, të riformulohet...Nuk po e lexoj të gjithë, se ju keni rënë dakord edhe te Komisioni i Integritetit.

Roland Kristo – Po, thjesht ka qenë çështje teknike kur është printuar nga Këshilli i Ministrave, sepse nuk e ka kapur pjesën më poshtë. Vetëm kaq. Ka qenë çështje teknike, se në formatin elektronik ekziston edhe ajo...

Eglantina Gjermani – Mbase duhet të votohet neni 1...

Niko Peleshi – Po.

Kush është dakord me nenin1, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Eglantina Gjermani – Për sa i përket nenit 2, përkufizimet që janë këtu, “peshkim tregtar artizanal” ose “peshkim bregdetar artizanal”, personalisht, më duken pak evazive dhe jo të njëjta. Pashë edhe direktivën e Bashkimit European. Nuk e di se si janë përkthyer, por nuk m’u dukën të njëjta. Ose ne nuk e kuptojmë shumë mirë, se nuk merremi me peshkim, ose ka ndonjë gjë që nuk shkon.

Roland Kristo – Për ta shpjeguar: në ligjin ekzistues emërtimi ka qenë “peshkim tregtar artizanal”. Natyrisht, me këtë është e lidhur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, artizanal. Është peshkim tregtar profesional dhe artizanal. Emërtimi aktual është “peshkim tregtar artizanal”. Kështu është emërtimi në ligjin aktual. Duhet të kemi parasysh se në bazë të këtij përkufizimi është edhe i gjithë sistemi që është ngritur më pas, kryesisht i QKB-së, i mënyrës së lëshimit të lejeve nëpërmjet QKB-së. Në rast se do ta ndryshonim dhe nga “peshkim tregtar artizanal” do të kishim thënë vetëm “peshkim bregdetar artizanal”, me përkufizimin e dytë, që është më korrekti, do të na duhej të negocionim dhe për ndryshimin e ligjit nr. 10081 të QKB-së, VKM-ëve dhe gjithë pjesës tjetër, si dhe të bindnim QKB-në që është e njëjta gjë. Ne kemi vendosur “ose”, që është e njëjta gjë, për të thënë se këto dy terma, ai që ka qenë më parë dhe ky që po shtojmë, janë e njëjta gjë. Nuk ka asnjë lloj ndryshimi, as për procedurat e dhënies së lejes, as në ndonjë gjë tjetër. Thjesht kaq është.

Peshkim jobregdetar, po flasim për peshkimin në ujërat e brendshme, që, po kështu, është peshkim artizanal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besnik Baraj - ... Nuk është bregdet, por është në thellësi dhe artizanal.

Roland Kristo – Jo, nuk shkon dot në thellësi, sepse duhet të kemi parasysh që pjesa se sa të afta janë anijet ta zhvillojnë aktivitetin nën 12 metra, certifikohet nga gjendja teknike e anijeve. Mund të jetë një anije 11,99 ose 12 metra e gjatë dhe mund të ketë motor me 500 kuaj fuqi. Kjo anije mund të shkojë deri në një farë distance ose ka aftësinë për të shkuar deri këtu. Aftësinë për të lundruar e certifikon regjistri detar. Këto anije zakonisht e kanë deri në 3 milje. Tej 3 miljeve, regjistri detar nuk i certifikon që të shkojnë.

Dallimi midis këtij grupi anijesh, që mund të kenë fuqi motorike të madhe dhe atyre që ekzaktësisht janë në peshkimin artizanal, bëhet me format e gjuetisë, që janë të specifikuara këtu, pra rrjetat me tërheqeje, format 1,2,3, që janë të specifikuar në këtë përkufizim. Pra, një anije mund të jetë 11,99 metra, mund të jetë anije fundore, që do të shkojë të peshkojë tej 3 miljeve, por në këtë rast nuk është anije e peshkimit artizanal. Në rast se nuk ka vegla fundore peshkimi, me ose pa timon, vegla peshkimi me tërheqe për peshkimin pelagjik me timon ose çiftpelagjik, rrjeta binjake me timon dhe dragëhidraulike, quhet peshkim artizanal. Në qoftë se ka një nga këto, nuk është më peshkim artizanal, por është peshkim tregtar profesional.

Eglantina Gjermeni – Meqenëse jemi te neni 2 dhe kemi përkufizime, unë nuk kam një përkufizim, por do të doja që sipas definicionit ose përkufizimit që ju propozoni, të shtohet edhe infrastruktura e peshkimit, se tek organizatat e peshkimit del që duhet të marrin infrastrukturë peshkimi, por se çfarë do të thotë infrastrukturë peshkimi nuk është gjëkundi e shkruar në ligjin ekzistues.

Nëse ju sillni një propozim konkret, do të na ndihmonit, që të shtohet te përkufizimet dhe të jemi të qartë te neni pasardhës se çfarë duam të themi me infrastrukturë peshkimi. Mbase le të shtohet si pikë.

Roland Kristo – Në parim nuk jam kundër. Për pjesën e shpjegimeve, te pika e fundit, se çfarë është infrastruktura e peshkimit dhe çfarë është infrastruktura e lidhur me peshkimin, ato janë pjesë të veçanta. Shkallët e riparimit të anijeve janë...

Eglantina Gjermeni – Asnjëra nuk është e përcaktuar te përkufizimet. Kanë dallim nga njëra-tjetra.

Roland Kristo – E thashë, në parim jam dakord me këtë. Mbas kësaj mbledhjeje mund të ulem me zonjat për të gjetur një përkufizim ekzakt.

Urdhëro? Për të dyja, nuk ka asnjë problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem që t'i shtojmë të dyja, se çfarë është infrastruktura e peshkimit dhe çfarë është infrastruktura e lidhur me peshkimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord, por unë shikoj që ka pasur edhe komente nga zonja Kolaneci për këtë nen. I keni marrë në konsideratë?

Roland Kristo – Janë të njëjta me komentin që ka bërë relatorja, për të shtuar... Jemi të gatshëm të diskutojmë.

Niko Peleshi – Ky është thelbi i komentit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, nuk ka vetëm këtë propozim zonja Kolaneci.

Roland Kristo - Më falni, kur të kalojmë te neni 64 dhe 65, për çështjet e tjera që ka ngritur zonja Kolaneci, kam sjellë përgjigjet dhe do t'i shikojmë... Rastet kur thotë se te cili nen kalon njëri rast, kush e drejton dhe kush nuk e drejton...

Niko Peleshi – Jemi te neni 2, për të cilin ka sugjerime.

Roland Kristo – Në lidhje me përkufizimin e infrastrukturës së peshkimit dhe të infrastrukturës së lidhur me peshkimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Vetëm ky sugjerim është për nenin 2?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Kush është dakord me nenin 2, sipas formulimit të Këshillit të Ministrave, me shtesën e dy përkufizimeve, për infrastrukturën e peshkimit dhe infrastrukturën e lidhur me peshkimin, siç e sqaroi zëvendësministri, por që do të formulohet më saktësisht nga shërbimi?

Kundër nuk ka.

Miratohet neni 2 me ndryshimin e mësipërm.

Roland Kristo – Më falni, mund të bëj edhe një shtesë të vogël?

Po kështu, në lidhje me përkufizimin e peshkimit për përdorimin e mjeteve lundruese, për të qenë më sqarues, “për zënien apo grumbullimin” ta zëvendësojmë me “për zënien apo vjeljen”. Për dikë që do të kishte dyshime se çfarë është grumbullimi, vjelja do ta përgjithësonte. Nëse është e qartë, e lëmë kështu.

Si të doni, por “grumbullim”, mund ta zëvendësojmë me “vjelje”.

(Diskutime pa mikrofon)

Për mua nuk ka rëndësi emërtimi në shqip. Rëndësi ka se cili është procesi, pra e grumbullon me dorë apo e vjel. Si të doni. Po të doni, e vëmë edhe e “korr”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Vazhdojmë.

Eglantina Gjermani - Duke qenë se peshkimi është fushë e re, na duhet të mësojmë, të lexojmë dhe t’i kuptojmë të gjitha gjërat.

Te neni 3 ka dalë e drejta e peshkimit. Ky është një sugjerim edhe nga zonja Kolaneci, por edhe duke parë gjithë projektligjin jam pak konfuzë se çfarë është e drejta e peshkimit dhe leja e peshkimit. A janë njësoj? Apo janë të ndryshme? A ka nevojë të qartësohen? A ka nevojë për përkufizim? Mbase unë nuk e kam kuptuar dhe janë njësoj, përdoren si sinonime.

Roland Kristo – Mund të bëj një sqarim?

Duhet të kemi parasysh një gjë, e drejta e peshkimit është një koncept që nuk është i thjeshtë, pak a shumë trajtohet si të drejtat e njeriut ose e drejta e përdorimit të një resursi. E drejta e peshkimit, në koncept, po ta marrin nga pikëpamja juridike, s’dua të bëj leksion, por i gjithë ligji e rregullon të drejtën e peshkimit, duke filluar nga lejet dhe të gjitha format e tjera. Lejet janë një nga mënyrat me të cilat zbatohet e drejta e peshkimit. Në të gjithë konceptin e

tij, mënyra se si rregullohet, se si organizohet dhe se si dikush e ka të drejtën për ta përdorur apo për të mos e përdorur një resurs, kjo është pjesë që rregullohet nga legjislacioni shqiptar për peshkimin dhe nga legjislacioni botëror. Theksi apo kuptimi qëndron tek e drejta për të zhvilluar aktivitetin e peshkimit në ujërat e brendshme pa përdorimin e mjeteve lundruese, bëhet me konkurrim publik.

Për sa i përket kësaj kategorie peshkimi, e drejta e peshkimit për anijet e peshkimit bëhet me sistemin e lejeve, që është e përcaktuar ndryshe.

E drejta e peshkimit për zhvillimin e aktiviteti në ujërat e brendshme bëhet përsëri me format e përcaktuara në ligj. Pra, e drejta është një gjë më universale. Forma se si rregullohet, përcaktohet me këtë ligj. Pra, në rastin e peshkimit me mjete lundruese bëhet nëpërmjet sistemit të lejeve (me ligjin nr. 10081 dhe VKM-në nr. 583).

Në rastin kur nuk kemi mjete lundruese bëhet me konkurrim publik dhe në rastin, kur bëhet në ujërat e brendshme, bëhet përsëri me konkurrim publik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo varet se për çfarë e kanë, nëse e bëjnë për qejf apo për biznes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur është për sport, është e rregulluar ndryshe. Edhe kjo është pjesë e të drejtës së peshkimit. Atyre u jepet e drejta e peshkimit që rregullohet. Ne ia kemi deleguar pushtetit vendor. Atë pjesë për peshkatarët që e kanë me grep, jo me rrjeta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Peshkimi me rrjeta nuk është peshkim për qejf, çlodhës dhe argëtues, por bëhet për të kapur më shumë peshk.

Peshkimi me grepa është pjesë e peshkimit amator. Të drejtën e tyre për ta zhvilluar këtë lloj aktiviteti, ia kemi deleguar pushtetit vendor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord.

Kush është dakord që neni 3 të miratohet sipas formulimit të variantit të Këshillit të Ministrave?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4.

Eglantina Gjermani – Për nenin 4, me ndihmën e këshilltares juridike, kemi bërë një propozim për ta riformuluar, si vijon:

Pas pikës 6, të nenit 30 të shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Leja e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det, me përdorimin e mjeteve lundruese, përfshihet në kategorinë III.5. A.2. të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

E drejta e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, fitohet nëpërmjet konkurrimit publik. Procedurat e konkurrimit publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Ky është sugjerimi që propozojmë.

Roland Kristo – Në fakt unë fola edhe me këshilltarin juridik. Për mendimin tim kjo bie ndesh me pikën 1 të nenit 30, në të cilën thuhet: “Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Nëse e shohim ligjin “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ka 2 kategori që merren me peshkimin: kategoria III.5 A1 dhe kategoria III.5 A2. Kategoria III.5 A1 merret me sistemin e të gjitha lejeve, që kalojnë nëpërmjet QKB-së, ndërsa kategoria III.5 A2, nëpërmjet konkurrimit publik, bëhet pa kaluar nëpërmjet QKB-së, pra bëhet nëpërmjet konkurrimit publik. Kjo nuk do të thotë që pastaj nuk i çohet njoftimi QKB-së që ky është fituesi. Kjo, për mendimin tim, thjesht do të krijojë një përplasje me ligjin “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Lejet e peshkimit kalojnë me kategorinë III.5A1, ndërsa kategoria III.5A2 është një kategori e posaçme e ligjit “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Eglantina Gjermeni – Unë i rikthehem sugjerimit. Duhet të ketë përcaktim e drejta e peshkimit dhe leja e peshkimit. Mendoj se me propozimin që bëmë për nenin 4, e sqarohej kjo gjë.

Përderisa ju e hidhni poshtë, duhet të sillni një argument tjetër dhe një propozim konkret se si do të bëhet realisht definicioni, si do të jetë e përcaktuar në ligj e drejta e peshkimit dhe leja e peshkimit, që ai të jetë i kuptueshëm për këdo që e lexon.

Roland Kristo – Ne po flasim për mënyrën dhe kjo është pjesë e procedurës se si do të zbatohet nesër nga administrata. Unë po them, se leja e peshkimit është kategoria III.5.

Ajo që mund të bëjmë për ta sqaruar, është që në vend të kësaj ta lëmë: kategoria III.5A1 te pika 1 e nenit 30, ndërsa te pika 7, e nenit 30 duke hequr pjesën e shtuar, ta lëmë: kategoria III.5A2, që QKB-ja ta dijë se ku ta kategorizojë njërin dhe ku ta kategorizojë tjetrën. Kaq. Kjo bëhet që të mos krijohen përplasje me QKB-në. Domethënë, te neni 30, pika

1 e ligjit ekzistues thotë: “Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Ne mund ta modifikojmë që këtu në pikën 1 dhe të themi: “1. Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5A1. ...”

“E drejta e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, fitohet nëpërmjet konkurrimit publik dhe përfshihet në kategorinë III.5 A2.”

Kjo bën dallimin se cila është njëra dhe se cila është tjetra. Pra, ta përcaktojmë kategorinë III.5A1, që është nëpërmjet QKB-së dhe kategorinë III.5 A2, që është formati ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këto dy kategori (III.5 A1 dhe III.5 A2).

Niko Peleshi – Si do të ishte formulimi, sipas këtij propozimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo – Te pika 1, e nenit 30 të thuhet: “Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5A1 të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Te pika 7 e nenit 30 të thuhet: “Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5 A2.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, do të shtojmë referimin III.5 A1 te pika 1, ndërsa te pika 7, do të shtojmë referimin III.5 A2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me riformulimin, siç e kishim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sepse te formulimi ynë e kemi thënë III.5 A2 dhe për lejet e peshkimit do të referohemi te III.5 A1.

Niko Peleshi – Si do të bëhet formulimi, sipas këtij propozimi për nenin 4?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, hedhim në votë nenin 4, sipas riformulimit të relatores.

Eglantina Gjermeni – Siç e thamë, te neni 4 do të shtohet një pikë, se pika 1 sipas ligjit ekzistues thotë: “Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5 A1 ...”.

Roland Kristo – Dakord, do të ndryshohet edhe pika 1 e nenit 30.

Eglantina Gjermeni – Po.

Pra, këtë po shtojmë sot. Nuk e sollët ju këtë ndryshim.

E lexoj edhe një herë: “Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5 A1 të shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Leja e peshkimit tregtar lëshohet, menaxhohet dhe hiqet në përputhje të plotë me procedurat e përcaktuara në këtë ligj dhe në Ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Po kështu, pas pikës 6 të nenit 30, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“Pika 7. E drejta e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, fitohet nëpërmjet konkurrimit publik dhe përfshihet në kategorinë III.5 A2. të shtojcës së Ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Procedurat e konkurrimit publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Roland Kristo – E heqim fjalën “kodin”, meqë ka përsëritje.

Eglantina Gjermeni – Dakord.

Niko Peleshi – Kush është dakord me nenin 4 të ndryshuar sipas riformulimit që sapo lexoi zonja Gjermeni?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4 me këto ndryshime.

Kalojmë te neni 5. Për këtë nen nuk ka ndryshime.

Kush është dakord që neni 5 të miratohet sipas formulimit të Këshillit të Ministrave?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5 sipas variantit të Këshillit të Ministrave.

Kalojmë te neni 6. Edhe ky nen nuk ka vërejtje.

Kush është dakord që neni 6 të miratohet sipas variantit të Këshillit të Ministrave?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7. Edhe ky nen nuk ka propozime për ndryshime.

Kush është dakord që neni 7 të miratohet sipas variantit të Këshillit të Ministrave?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8.

Urdhëroni!

Eglantina Gjermani – Për të dyja pikat e nenit 8 kam një sugjerim, sepse me sa duket, ato janë marrë nga direktiva e BE-së dhe do të kenë ndonjë problem me përkthimin. Po e lexoj siç është, sepse mendoj se duhen ndryshuar dhe për këtë kërkoj ndihmën tuaj. “1. Organizatat prodhuese të peshkimit krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të peshkimit dhe që njihen sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.”

Unë propozoj që pjesa “dhe që njihen” të hiqet, sepse nuk shkon në shqip dhe nuk ka kontekst. Mbase në vendet e BE-së mund të njihen nga vendet atje, por këtu te ne kjo më duket si një togfjalësh parazitar, që nuk i shton asgjë fjalisë.

Mendoj të bëhet: “1. Organizatat prodhuese të peshkimit krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të peshkimit sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.”

Roland Kristo – Më falni!

Duhet t’i referohemi nenit 62 të ligjit ekzistues. Fatkeqësisht apo fatmirësisht (quajeni si të doni), këtu të gjithë thonë se janë organizata prodhuesish, se janë organizata menaxhimi në këtë apo në atë formë. Ajo organizatë, e cila ngrihet sipas këtij ligji, që ka një akt njohjeje siç e përcakton neni 62 i ligjit aktual: “Ministri, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga përfaqësuesi i organizatës përkatëse dhe pas verifikimit për plotësimin e kushteve të përcaktuara nga ky ligj, vendos brenda tre muajve për njohjen e saj.”

Pra, je një organizatë prodhuese, e njohur sipas ligjit nr. 64, je një organizatë partnere, e cila mund të vazhdojë me të gjithë pjesën tjetër të procedurave të parashikuara nga ligji, në qoftë se unë do ta bëj partnere, qoftë për menaxhimin e resurseve, qoftë për menaxhimin e infrastrukturës.

Në të kundërt, nesër do të dalin si këto organizatat ose shoqatat që krijohen me 3 vetë dhe thonë: “Jam edhe unë organizatë prodhuese”, por që nuk njihen, nëse nuk janë sipas kësaj procedure. Ky është sensi. Njohja e organizatave është procedurë dhe me vendet e BE-së. Ministria krijon regjistrin, për të gjitha organizatat e njohura nga ministria dhe që janë organizata partnere me të cilat ajo diskuton, ndan përgjegjësitë qoftë të menaxhimit, qoftë edhe përgjegjësi të tjera.

Eglantina Gjermeni - Unë sugjeroj të riformulohet edhe me ndihmën e këshilltares juridike: “Organizatat prodhuese të njohura sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të peshkimit”. Jemi dakord?

Roland Kristo - Nëse nuk ndryshon thelbi, jemi dakord. Drejtoresha Juridike është dakord, edhe unë jam dakord.

Eglantina Gjermeni – Jo, nuk ndryshon thelbi.

Fjalë e dytë, pika e dytë po në këtë nen, për mua është e pakuptueshme, por ju ndoshta mund të na e sqaroni, sepse është shumë evazive. Ju thoni: “Kur është e nevojshme në momentin e themelimit të organizatës prodhuese duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël”. Kjo është shumë evazive, nuk nënkupton asgjë. Çfarë do të thotë “Gjendja e prodhuesve të vegjël”? Gjendja ekonomike, financiare? Si duhet të jetë që ta formulojmë?

Roland Kristo - Ky është fjalë për fjalë përkthimi i Rregullores. Duhet të kemi parasysh një gjë, kjo është edhe pjesa e frikës që u ngrit, se mos organizatat e mëdha prodhuese do të shkelin me këmbë prodhuesit e vegjël. Marrim rastin e peshkimit të vogël artizanal. E thashë që në fillim se organizatat prodhuese sot në BE janë një nga format të cilat mbështeten. Teorikisht dhe praktikisht nëse ne i kthehemi të gjithë pjesës ende të papërshtatur, apo të adoptuar në legjislacionin shqiptar të rregullores nr. 1379 të vitit 2013, organizatat prodhuese merren që nga prodhimi, zënia në det, transporti, përpunimi ose bërja gati për shitje dhe deri te hedhja në treg. Pra, mbulojnë të gjithë zinxhirin e peshkimit. Në këto kushte frika më e madhe në të tilla raste mund të jetë që organizatat prodhuese mund të krijojnë monopol, për shembull, kur krijohen organizatat e të gjithë prodhuesve të mëdhenj. Vendosi e kushtit në ligj që do të mbrojnë interesat, kushtet specifike të prodhuesve të vegjël, të atyre që nuk kanë interes të përfshihen në organizatat prodhuese është një pjesë që i jep garancinë, pavarësisht se të gjithë pjesës tjetër të legjislacionit plotësues që do të miratohet me aktet nënligjore i jep format. Përpara fillimi të vitit ushtrimor, duhet të....

Eglantina Gjermeni - E mirëkuptoj, por ky nen vetëm atë që thatë ju nuk e bën. E para, nuk i respekton, nuk i mbron, përkundrazi për të krijuar ndonjë monopol, jo e jo që nuk e bën. Nuk e bëjnë edhe nene të tjera. Të paktën të riformulohet shqip.

Roland Kristo - Mban parasysh gjendjen specifike të prodhuesve të vegjël.

Eglantina Gjermeni – Çfarë do të thotë?

Roland Kristo - Në çfarë kushtesh janë, çfarë niveli prodhimi kanë, çfarë tregu kanë.

Eglantina Gjermeni – Po mirë, e pa këtë gjendjen që është sot. Çfarë bën me këtë nen?

Roland Kristo - Në të gjithë pjesën e zbatimit të politikave të saj, nuk mund të hyjë në një treg specifik që është zënë nga prodhuesit e vegjël.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

5-10 kilogramë nuk ka rëndësi. Prodhuesit e vegjël mund të jenë jo me 5 kilogram në peshë, por mund të jenë diçka më shumë. Ai që mund të shkojë ta shesë mund të ketë kanal komunikimi ose shitje të drejtpërdrejt te një seri dyqanesh ose klientësh. Organizatat e prodhuesve të vegjël duhet të mbajnë parasysh se kjo pjesë e tregut është e prodhuesve të vegjël. Këto janë kushtet, specifikat që duhet të mbahen parasysh.

Eglantina Gjermeni - Kush e ka këtë detyrim?

Kush duhet ta mbajnë parasysh: ministria, organizatat, institucioni? Vlen për t'u njohur apo kanë ndonjë rëndësi, impakt tjetër? Gjendja ekzistuese duhet për ta njohur, për njohjen që folëm më lart?

Roland Kristo - Janë në kushtet që të quhen organizata prodhuesish. Më thoni ju një përkufizim për ta bërë më të qartë. Unë kam marrë përkufizimin fjalë për fjalë atë që ka BE-ja. Ky është një paragraf i një neni, i një rregulloreje specifike të BE-së, e cila e gjitha do të transpozohet. Nuk bëhet dot ligji rregullorë, duke futur 30 nene.

Niko Peleshi - Cila e bën njohjen e organizatave?

Roland Kristo - Ministria.

Niko Peleshi - Atëherë, për mendimin tim thjesht të saktësohet kur është e nevojshme në momentin e themelimit të organizatës së prodhuesve, ministria apo autoriteti duhet të mbajë parasysh gjendjen specifike të prodhuesve të vegjël.

Roland Kristo - Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të vendosim kushtet e njohjes.

Niko Peleshi - Riformulimi duhet të jetë pak a shumë: “Në momentin e themelimit të organizatave prodhuese autoriteti përgjegjës për njohjen duhet të mbajë parasysh gjendjen specifike të prodhuesve të vegjël”. Ka ndryshim tjetër në këtë nen?

Kush është dakord me nenin 8 me ndryshimin në pikën 1 siç e lexoi relatorja dhe ndryshimin në pikën 2 siç e riformulua? Patjetër që duhet të saktësohet edhe nga shërbimet e komisionit.

Roland Kristo – Jo në momentin e themelimit, por në momentin e njohjes. Ai mund të themelohet, por ne kur e njohim...

Niko Peleshi - Dakord. Po e lexoj edhe një herë pikën 2 para se ta votojmë nenin. “Në momentin e njohjes së organizatës prodhuese nga autoriteti përgjegjës duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël”. Pak a shumë me këtë formulim dhe me formulimin e pikës 1 siç e lexoi relatorja e hedhim në votim. Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me ndryshimet e pikave 1 dhe 2 siç i thamë më lart. Neni 9.

Eglantina Gjermani - Nuk kam ndonjë formulim konkret, por i vetmi shqetësim që kam është se në ligj janë objektivat e organizatës prodhuese, jam si në dilemë që në një ligj të jenë kaq të përcaktuara. E kuptoj mund të jenë ndoshta të përkthyer nga direktivat e BE-së.

Roland Kristo - Si do t'i njohim nëse nuk kemi disa kriteret të vendosura në ligj?

Eglantina Gjermani- E di, por nuk kemi të njëjtën logjikë edhe për gjerat e tjera. Është direkt nga direktiva e BE-së, besoj? Dakord.

Roland Kristo – I njohin të gjitha format, organizatë prodhuese, organizatë menaxhimi, kooperativat. Nuk ka rëndësi sesi ia vendos emrin. Organizatat e menaxhimit të peshkimit, për shembull janë kooperativa shërbimesh. Dikë e bën alergjik fjala “kooperativë”, e shpjegojmë edhe në fillim.

Niko Peleshi - Nëse mund të krijohet një kooperativë peshkimi, cilit ligj mund t'i referohet?

Roland Kristo - Ne e njohim si kooperativë, sepse e kemi termin kooperativë në ligjin tonë.

Niko Peleshi - Ligji “Për peshkimin”?

Roland Kristo - Po.

Niko Peleshi – Cili është ndryshimi ndërmjet organizatës për menaxhimin e peshkimit dhe kooperativave?

Roland Kristo - Në parim nuk ka ndryshim. Organizata e menaxhimit të peshkimit është kooperativë. Në momentin e parë kur është futur koncepti i organizatave të menaxhimit të peshkimit, termi i parë ka qenë kooperativë. Kur është bërë diskutimi me peshkatarët fjala kooperativë i hodhi përprjetë. Atëherë ishte Banka Botërore që tha: “Po e heqim fjalën “kooperativë” dhe po vendosim “organizatat e menaxhimit të peshkimit”. Në fund të fundit organizatat e menaxhimit të peshkimit janë kooperativa shërbimesh. Pra, është e njëjta gjë.

Niko Peleshi – Ju kuptoj. E keni në ligj termin “kooperativë” apo jo? Nëse është në ligj, atëherë duhet të ketë një dallim. Nuk besoj se përdoret i njëjti term për të nënkuptuar të njëjtën gjë.

Roland Kristo – Në ligjin aktual neni 58 thotë: “ Organizatat e peshkimit janë persona juridikë, privatë që krijohen me nismën e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund të jenë në një nga format e mëposhtme: organizatë prodhuesish, organizatë e menaxhimit të peshkimit, kooperativat dhe forma të tjera organizimi dhe menaxhimi”. Ne i kemi futur të gjitha, i kemi përfshirë në organizatë peshkimi. Kooperativa është organizatë peshkimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi - Nuk janë të detajuara format e tjera të organizimit, të kooperimit?

Roland Kristo - Në nenin 59 kemi strukturat organizative të peshkimit, se çfarë duhet të kenë. Neni 60 merret në mënyrë specifike me organizatat e menaxhimit të peshkimit. Neni vijues merret me organizatat prodhuese.

Niko Peleshi – Po për kooperativat?

Roland Kristo – Jo, nuk e ka të specifikuar se çfarë është kooperativa në detajim, por e quan organizatë peshkimi.

Niko Peleshi - Jo organizata e peshkimit është tjetër.

Roland Kristo – Në pikën 1 të nenit 59 thuhet: “ Organizatat e peshkimit mund të jenë një nga format e mëposhtme: organizatë prodhuese...”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta zgjedhin vetë si të duan, ose të jenë organizatë prodhuese ose organizatë menaxhim peshkimi ose kooperativë ose të jetë një formë tjetër.

Niko Peleshi – Normalisht me këtë rast duhet të ishte plotësuar edhe kjo pjesë. Duket që ka një boshllëk. Kooperativa është një term në ajër. Është një organizatë peshkimi, kooperativë, por e parregulluar me nenet në ligj, për shembull siç është organizata e menaxhimit të peshkimit, por nuk kemi çfarë t’i bëjmë tani. Puna është nëse krijohet si kooperativë çfarë rregullimesh ka? Në bujqësi është ndryshe, nuk quhen kooperativa, por shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe ka një ligj të posaçëm për to.

Ne neni 9 kemi disa ndryshime të Komisionit për Integrimin. Kemi bërë ndryshim tjetër në këtë nen? Kush është dakord me nenin 9 me ndryshimet që ka bërë Komisioni i Integritetit, me variantin e ndryshuar të Komisionit për Integrimin? Nuk po e lexoj, sepse e keni përpara. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me variantin e Këshillit të Ministrave dhe ndryshimet e Komisionit të Integritetit.

Më falni!

Te ky nen kemi bërë një diskutim herën e kaluar për planet e menaxhimit, se cili duhet t'i hartojë ato: organizatat e menaxhimit të peshkimit apo ministria. Kemi bërë analogjinë me planet e menaxhimit të pyjeve: i harton ministria dhe i zbatojnë subjektet.

Roland Kristo - Planet e menaxhimit i hartojnë organizatat dhe i miraton ministria. Pa miratimin e ministrisë, ato nuk janë të vlefshme.

Niko Peleshi – Ku specifikohet kjo?

Roland Kristo - Është te ligji ekzistues.

Niko Peleshi - Është e përcaktuar në ligj?

Roland Kristo - Po dhe janë me firmë dhe me vulë nga ministri. Në rast se krijohen zonat e bashkëmenaxhimit brenda një viti, propozohet nga ata dhe miratohet nga ministria, nëse është në rregull apo jo.

Niko Peleshi – Po, zoti Marto.

Andrea Marto - Kam një vërejtje gjuhësore, që është dhe në nenet e tjera, por këtu përmendet dy herë. Përmendet shpesh fjala “resurs”, kur ne kemi fjalën shqipe “burim”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Kristo - Në lidhje me planet e bashkëmenaxhimit është pika 2 e nenit ...

Niko Peleshi – Të lutem, nuk ka problem!

Neni 10 sipas variantit të Këshillit të Ministrave apo ka ndonjë gjë?

Eglantina Gjermani - Ramë dakord që infrastrukturën e peshkimit apo ato që kanë lidhje me peshkimin do t'i vëmë si përkufizime.

Niko Peleshi- Kush është dakord me nenin 10 sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12.

Roland Kristo - Më falni!

Te neni 11 duam të bëjmë një ndryshim të vogël. Për menaxhimin e infrastrukturës të lidhur me peshkimin, aktualisht është germa “c”: “Menaxhimin i infrastrukturës të lidhur me peshkimin nga subjektet private”, duam të shtojmë këtu : “ Nga institucionet e qeverisjes vendore ose bashkitë (si të doni) dhe subjektet private”. Të shtojmë edhe fjalën “bashkitë”, nëse ju e miratoni këtë gjë.

Niko Peleshi – E hedhim edhe një herë në votim nenin 11. Neni 65 i ligjit ekzistues propozohen disa ndryshime, të cilat nuk po i lexoj, sepse ramë dakord që t'i pranojmë sipas variantit të Këshillit të Ministrave, por te germa “c” bëjmë këtë riformulim: “Menaxhimi i infrastrukturës të lidhura me peshkimin nga njësitë e qeverisjes vendore dhe subjektet private”. Pra, të shtojmë “njësitë e qeverisjes vendore”.

Roland Kristo - Kjo do të thotë që edhe në pikën 3 të këtij neni të shtohen fjalët “njësitë e qeverisjes vendore dhe subjektet private”, sepse ishte parashikuar vetëm në dy forma.

Niko Peleshi- Të shtohen fjalët “njësitë e qeverisjes vendore dhe subjektet private” edhe në pikën 3.

Pika 3 bëhet: “Kushtet dhe procedurat e transferimit dhe menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit, njësitë e qeverisjes vendore dhe subjektet private miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Roland Kristo - Saktë.

Niko Peleshi - Kush është dakord me këto ndryshime? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11 sipas variantit të Këshillit të Ministrave me dy ndryshimet e mësipërme.

Neni 12.

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Lidhur me nenin 12 kam një problem, duket se është i mangët për faktin se thotë që institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës titullohet, por nuk ka të përcaktuar fushat e përgjegjësisë. Ne kishim objektivat e organeve të peshkimit te neni 12, ndërkohë që te ligji ekzistues është drejtoria, këtu kalon në institucion përgjegjës dhe nuk ka fushat e veprimtarisë të cilat duhet të jenë të përcaktuara në ligj. Ne kemi përcaktuar organet e peshkimit dhe objektivat e tyre ndërkohë që këtë këtu e kemi institucionin përgjegjës, por nuk kemi fushat e përgjegjësisë.

Roland Kristo - Fushat e përgjegjësisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Eglantina Gjermani - Atje hiqni edhe objektivat se nuk ka sens. Ky është institucioni kryesor. I keni te ligji ekzistues.

Roland Kristo – Më falni!

Te pjesa që ka të bëjë me privaten është pjesë që duhet të jemi pak më striktë. Nëse doni që ne të shtojmë edhe objektivat...

Eglantina Gjermeni - Jo, se dua unë, por është detyrim ligjor që ta përcaktoni në ligj fushën e veprimtarisë së institucionit përgjegjës.

Roland Kristo - E vetmja gjë që është bërë, është riformulimi i ligjit ekzistues.

Eglantina Gjermeni- Në ligjin ekzistues janë fushat e përgjegjësisë dhe mund ta lexoni.

Roland Kristo – Duhet të keni parasysh një gjë, ky ka qenë një diskutim që kemi pasur me Ministrinë e Drejtësisë. Me detyrat që ka pasur institucioni përgjegjës ose DSHPA-ja nuk i është hequr asnjë element asnjë gjë më shumë. Në përgjigjen që i kemi kthyer Ministrisë së Drejtësisë i kemi thënë se funksioni sipas pikës 3, germa “b” të nenit 66 është ndryshuar në nenin 125, i cili kishte të bënte me grumbullimin e të dhënave, sepse ligji “ Për peshkimin” në vitin 2017 u ndryshua me ligjin nr.80. Pjesa e grumbullimit të të dhënave u hoq si pjesë e detyrave që kishte DSHPA-ja dhe do të bëhet nëpërmjet sistemit të monitoruesve. Po kur u bënë ndryshimet në nenin 125, iu la akoma si detyrë DSHPA-së, gjë që binte ndesh mes njëres e tjetres. Prandaj është hequr pjesa e grumbullimit të të dhënave. Në lidhje me detyrat, ato janë të përcaktuara te neni më sipër. I vetmi ndryshim që i bërë ishte: harton programet e ripopullimit. Programet nuk i harton dot një drejtori shërbimi, por ministria. Zbaton ose ka në menaxhim qendrat e prodhimit të rasateve. Janë ata që prodhojnë rasate, që merren me programet e ripopullimit. Pra, politikat i harton ministria.

Nuk ka asnjë gjë që t’i jetë hequr autoritetit, nga çfarë ka pasur më përpara. Domethënë, asnjë lloj ndryshimi. Një pjesë ka qenë përsëritje, dhe referohen në nenin e mësipërm. Me ndryshimin e ligjit 80/2017, gabimisht pika me grumbullimin e të dhënave nuk ishte hequr. Pjesa e hartimit të politikave është riformuluar, që ka nën përgjegjësi administrimi qendrat e prodhimit të rasateve, që është e njëjta gjë. Nuk harton politikat, por merret me prodhimin e rasateve.

Eglantina Gjermeni – Më fal, që të jemi korrekt, sepse mbase edhe te gjithë janë të lodhur; mendoj se duhet përcaktuar me ligj, meqenëse është një institucion që krijohet nga ligji. Juristja mund të më ndihmojë. Në momentin që një institucion krijohet nga ligji, duhet të ketë në ligj fushat e përgjegjësisë. Është shumë e thjeshtë, nuk ka pse diskutojmë. Mund t’i referoheni ligjit, dhe ta plotësojmë.

Edlira Llango – Në fakt ka disa fusha përgjegjësie, dhe me ndryshimet aktuale që po i bëjmë ligjit, vetëm po heqim disa përsëritje që ishin në nenet e mëparshme, për sa i përket fushës së përgjegjësisë së kësaj drejtorie. Hiqet vetëm hartimi i programit të ripopullimit të kategorive, duke qenë se nuk bën sens t’i takojë këtij institucionit. Këto ndryshime ligjore synojnë vetëm kaq dhe këtë bëjnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Pra, kush është dakord që të miratohet sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? S’ka.

Miratohet!

Neni 13. Kush është dakord, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër? S’ka.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku, te neni 13?

Eglantina Gjermeni – Duhet të shtojmë një afat. Meqenëse themi se ngarkohet ministri përgjegjës për peshkimin dhe ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e aktit nënligjor, në zbatim të pikës 6, le të vëmë një afat.

Roland Kristo – Pjesa e pikës 6 është ajo e tarifave. Në qoftë se doni për pjesën e akteve të tjera shtesë, që parashikohen...

Eglantina Gjermeni – Duhet të shtojmë një nen tjetër mbase?

Niko Peleshi – Një pikë tjetër të nenit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermeni – Të shtojmë një nen apo një pikë?

Edlira Llango – Duhet të shtojmë një pikë tjetër, jo një nen më vete.

Eglantina Gjermeni – Te neni 13 ta shtojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 13 shtohet, po.

Niko Peleshi – Si do të formulohet pika 4?

Eglantina Gjermeni – Aktet nënligjore të këtij ligji... Varet nga afati kohor. Gjashtë muaj, dymbëdhjetë muaj? Aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji hartohen dhe miratohen brenda dymbëdhjetë muajsh.

Niko Peleshi – E hedhim në votim nenin 13, duke shtuar një pikë, pikën 4, sipas formulimit që sapo lexoi relatorja, zonja Gjermeni.

Kush është dakord me nenin 13, sipas variantit të Këshillit të Ministrave, me shtesën e pikës 4? Kundër? S’ka.

Miratohet!

Neni 14 ka lidhje me hyrjen në fuqi. Kush është dakord?

Miratohet!

Ka edhe një ndryshim të propozuar nga Komisioni i Integritetit, në lidhje me titullin, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thamë atë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E votuam? Ka lidhje me ndryshimin, e shënimit në fund të faqes, sipas Komisionit të Integritetit.

Kush është dakord edhe me këtë ndryshim? Kundër? S'ka.

Miratohet!

Tani kemi votimin në tërësi.

Kush është dakord me miratimin në tërësi të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31. 5. 2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar.”

Kundër? S'ka.

Miratohet!

Faleminderit! Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA